

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj synon harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit për procedurat tatimore në vendin tonë lidhur me faturimin, me përcaktimet e projektligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, i cili sjell një risi në procesin e faturimit dhe të monitorimit të transaksioneve, harmonizimin dhe unifikimin e kundërvajtjeve administrative që lidhen me çështjet e faturimit, si dhe rregullimin e disa çështjeve teknike që lidhen me administrimin e detyrimeve tatimore të propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Në kuadër të objektivave për minimizimin e ekonomisë informale në vendin tonë, të përmirësimit të mbledhjes së të ardhurave tatimore, por edhe në kuadër të nevojës që legjislacioni tatimor të jetë në të njëjtin drejtim me zhvillimet teknologjike, tashmë është duke u implementuar projekti “Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit (fiskalizimi)”, me përfitues Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Ky projekt është materializuar edhe në projektligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, i cili, pasi kaloi fazat e konsultimit, është përcjellë për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Në këtë kontekst, meqenëse projektligji për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit sjell risi dhe ndryshime në sistemin e faturimit e të monitorimit të qarkullimit, përfshirë në një të ardhme të afërt edhe faturën elektronike (*e-invoice*), është e nevojshme të harmonizohen e përshtaten dispozitat përkatëse të ligjit të procedurave tatimore lidhur me faturimin, me parashikimet e këtij projektligji.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* me Bashkimin Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 30 nene, të cilat parashikojnë si vijon:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar projektligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, i cili propozon krijimin e një sistemi të ri faturimi e monitorimi të transaksioneve të bizneseve në vend, të shoqëruara me një risi në pajisjet fiskale. Qëllimi kryesor i këtij ligji është të krijojë një regjistër të subjekteve që lëshojnë fatura dhe kështu të kontrollojë përmbajtjen e tyre, të monitorojë të gjitha faturat e lëshuara (pavarësisht nëse ato paguhet me apo pa para në dorë) gjatë kryerjes së transaksioneve B2C (*Business to Consumer*), B2B (*Business to Business*) dhe B2G (*Business to Government*), si dhe pagesat e faturave të lëshuara e të regjistruara pa para në dorë, në kohë reale, nga administrata tatimore e Republikës së Shqipërisë.

Aktualisht, dispozitat që parashikojnë elementet e faturës tatimore, mënyrën e faturimit, si dhe kontrollin e transaksioneve me para në dorë, nëpërmjet sistemit të pajisjeve fiskale, janë të parashikuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Meqenëse ligji për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit do të ndryshojë sistemin e faturimit e të monitorimit të transaksioneve, atëherë lind nevoja për ndryshime në dispozitat përkatëse të ligjit nr.9920/2008.

Në nenin 1 të projektligjit propozohen ndryshime të nenit 41, të ligjit.

Në nenin 2 të projektligjit propozohen ndryshime të nenit 46, të ligjit.

Në nenin 3 propozohen ndryshime të nenit 47, të ligjit.

Në nenin 4 propozohet shfuqizim i pikës 3, të nenit 48, të ligjit.

Në nenin 5 propozohet shfuqizimi i neneve 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55 dhe 56, të ligjit.

Në nenin 6 propozohen ndryshime të nenit 57, të ligjit;

Në nenin 7 propozohen ndryshime të nenit 58, të ligjit.

Në nenin 9 propozohen ndryshime të nenit 71, të ligjit.

Në nenin 13 propozohen ndryshime të nenit 80, të ligjit.

Në nenin 14 propozohen ndryshime të nenit 81, të ligjit;

Në nenin 15 propozohen ndryshime të nenit 83, të ligjit.

Në nenet 16 e 17 shtohen rregulla, të cilat do përcaktohen me urdhër të ministrit.

Në nenin 18 riformulohet shitja e pasurisë së konfiskuar.

Dispozitat e sipërcituara propozohet të ndryshohen me synim përshtatjen e harmonizimit të terminologjisë dhe ndryshimet e propozuara në sistemin e faturimit me anë të ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” .

Ndërkohë, në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar aktualisht parashikon edhe penalitete në rast të shkeljeve që lidhen me dokumentimin tatimor dhe transmetimin e shitjeve me para në dorë, dispozita që janë propozuar të ristrukturohen në përputhje me ndryshimet e propozuara në projektligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit. Për këtë qëllim janë propozuar ndryshimet në nenet e mëposhtme:

Në nenin 21 të projektligjit propozohen ndryshime të nenit 121 të ligjit.

Në nenin 22 propozohen ndryshime të nenit 122 të ligjit.

Në nenin 23 propozohen ndryshime të nenit 123 të ligjit.

Në nenin 24 propozohen ndryshime të nenit 124 të ligjit.

Në nenin 25 propozohen ndryshime të nenit 124/1 të ligjit.

Në nenin 26 propozohen ndryshime të nenit 125 të ligjit.

Në nenin 27 propozohen ndryshime të nenit 128/1 të ligjit.

Në nenin 28 propozohen ndryshime të nenit 129 të ligjit.

Penalitetet janë rishikuar dhe rikonceptuar duke synuar harmonizimin dhe unifikimin e tyre lidhur me kundërvajtjet administrative me natyrë të njëjtë, me synim krijimin e një sistemi penalizimi, i cili nuk synon të dëmtojë, por njëkohësisht nuk nxit dhe incentivon mospajtimin me ligjin.

Ndërkohë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë propozuar disa ndryshime, të cilat kanë ardhur si rezultat i zbatimit në praktikë të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në nenin 8 të projektligjit është ndryshuar neni 67, duke kufizuar ndryshimin e deklaratës nga tatimpaguesi me vetëm 1 herë, si dhe janë unifikuar dispozitat e ligjit për tatimin me të ardhurat lidhur me ndryshimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave.

Në nenin 10 të projektligjit janë propozuar dy shtesa në nenin 75. Në këtë nen është parashikuar mundësia e kompensimit të detyrimeve tatimore të parashikuara në ligjin “Për procedurat tatimore” me gjendjen kreditore që mund të ketë një tatimpagues pas miratimit të titullarëve të institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve tatimore.

Në nenin 11 të projektligjit është parashikuar se, në raste të veçanta, me kërkesë të administratës tatimore, marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet edhe për detyrime që administrata tatimore ka ndaj tatimpaguesve, të tilla si: kërkesa të miratuara për rimbursimin e TVSH-së, pasi më parë palët kanë rënë dakord për planin e pagesave me këste të këtij detyrimi. Kjo dispozitë do të zbatohet deri më 30.6.2021.

Në nenin 12 të projektligjit është propozuar një shtesë në nenin 77. Në këtë dispozitë është shtuar gama e detyrimeve për të cilat tatimpaguesi mund të hyjë në marrëveshje me këste, duke synuar uljen e borxhit tatimor.

Neni 16 propozon ndryshime në nenin 96, ku propozohet të shtohet një paragraf “Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me udhëzim të përbashkët, përcaktojnë procedurat që do të zbatohen për efekt të regjistrimit të fitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme të konfiskuar nga administrata tatimore sipas aktit administrativ të konfiskimit dhe procedurat që do të zbatohen për shitjen e tyre në ankand.

Ky propozim vjen pasi, ndonëse ligji nr.111/2018, “Për kadastrën”, në nenin 47/1, të tij, parashikon shprehimisht se regjistrimi i fitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin apo kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, bëhet nga drejtoria vendore, pas paraqitjes së këtyre akteve, sipas procedurës së parashikuar në nenet 24 e 25, të këtij ligji, dhe plotësimit të kushteve të regjistrimit, të parashikuara në nenin 193, të Kodit Civil, deri më sot, ende nuk ka një procedurë të qartë e të zbatuar për fitimin e pronësisë të pronave të konfiskuara tatimpaguesve debitorë.

Në nenin 17 të projektligjit parashikohen ndryshime në nenin 103, lidhur me deklarinimin si të pambledhshëm, të detyrimit tatimor apo të një pjese të tij, për shuma nga 1 milion lekë deri në 5 milionë lekë.

VII.INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin dhe administrimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII.RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji nuk parashikohet të sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE